




Planuar / Dorezuar Prijemeno/Prdato Received / Delivery	22.12.2022	viti god year	2022
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMISHCK	8375/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1000/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1000/2022 të datës 11.11.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Prizren, kundër organit të punësimit/Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1000/2022 e datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 11.11.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me nr. A.nr.1000/2022 me numër protokolli 7036/2022, kundër rezultatit/testit me shkrim lidhur me pozitën Specialit të Ekonomisë -Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.11.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Prizrenit. Ndërsa, Këshilli më datë 08.12.2022 ka pranuar përgjigjen nga organi i punësimit me numër protokolli 7772/2022 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me ankesën ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 7036/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit të datës 23.06.2022 për pozitën "Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme", emri i grupit Specialist të Ekonomisë; Njoftimi i datës 09.11.2022 për shpalljen e rezultateve të testit me shkrim; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.11.2022 me numër protokollit 7121/2022; Përgjigje në ankesë e datës 08.12.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 7772/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Përgjigje në kërkesë e datës 06.12.2022 nga Menaxheri i Personelit i Komunës së Prizrenit; Lista e aplikantëve ; Lista e kandidatëve të aprovuar; Lista e kandidatëve të refuzuar; Njoftimi i datës 25.07.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; Aplikacioni i datës 14.07.2022 i ankuesit

Diplomë e datës 07.06.2001; Kontratë për regjistrimin në Institutin Kaf për vijimin e trajnimit kualifikues profesional "Teknik i Kontabilitetit", e datës 01.02.2022; Aneks marrëveshje për angazhim në masën aktive të tregut të punës -praktikë në punë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës e datës 26.10.2021 me nr.04-052-739; Çertifikatë e datës 06.11.2002 dhe kopja e letërnjoftimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është **palejuar, sepse:**

Nga administrimi i provave, Kolegji ka gjetur se Komuna e Prizrenit më datë 23.06.2022 ka publikuar konkursin me Nr.Reference RN00009287 për grup Specialist të Ekonomisë-për pozitën Zyrtar për Evidentimin e Pronës së Paluajtshme, ku afati për aplikim ka qenë nga data 14.07.2022 deri më datë 21.07.2022. Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar dhe ankuesi, i cili në bazë të Njoftimit të datës 25.07.2022 është përfshirë në listën e ngushtë duke i'u nënshtruar procedurave të tjera të pranimit (testit me shkrim) i cili është mbajtur me datën 09.11.2022. Pas përfundimit të testit me shkrim të procedurës së pranimit për pozitën e lartcekur, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prizrenit po me të njëjtën datë ka njoftuar ankuesin se është vlerësuar me gjithsej 28 pikë duke mos kaluar në fazën tjetër të vlerësimit të kandidatëve.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se nuk i është lejuar e drejta e ankesës, të verifikohet procesi i testimit me shkrim dhe pretendim tjetër i ankuesit është se dyshon se i kanë ndihmuar një aplikante të komunitetit boshnjak. por sipas përgjigjes së Menaxherit të Personelit në Komunën e Prizrenit të datës 06.12.2022 edhe aplikantja e komunitetit boshnjak nuk e ka kaluar testin me shkrim e njëjta ka marrë 28 pikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton se ankuesi pas njoftimit të datës 09.11.2022 i cili është njoftuar se nuk e ka kaluar testin me shkrim nuk ka parashtruar fare ankesë në Komisionin e Pranimit, ndërsa ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil nuk ka sjell asnjë dëshmi që ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit kundër Njoftimit të datës 09.11.2022 këtë e ka konfirmuar autoriteti punëdhënës në përgjigjen në ankesë të datës 06.12.2022, ku ka theksuar që: "...ju njoftojmë që ankuesi nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin e Pranimit lidhur me këtë procedurë të rekrutimit", si rrjedhojë bazuar në këtë ankuesi nuk ka vepruar sipas nenit 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të

parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual”.

Bazuar në këtë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi përkatës siç parashihet me nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”) . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet”,* si rrjedhojë meqenëse nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi të ketë parashtruar ankesë të brendshme tek organi i punësimit, atëherë sipas Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, kandidatit në procedurë të pranimit nuk i lejohet të parashtrojë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimit, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”,* po ashtu ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është në kundërshtim me nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave poashtu bazuar në pretendimin e ankuesit sa i përket çështjes se një aplikante nga komuniteti boshnjak është ndihmuar përkatësisht favorizuar në test nga komisioni ,konstaton se ky pretendim nuk është i bazuar për faktin se sipas përgjigjes së Menaxherit të Personelit në Komunën e Prizrenit të datës 06.12.2022 edhe aplikantja e komunitetit boshnjak nuk e ka kaluar testin me shkrim e njëjta ka marrë 28 pikë.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1000/2022, datë 22/12/2022

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.